



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Prilbjen:		
09.12.2022		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-352/01-65468		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

Datë:	09.12.2022
Referencë:	1-352/01-65468-1
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi – Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Grupi punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2023-2027 si dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformën e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport: Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2023-2027



Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Grupi punues për hartimin e PLVMM ka shpall në Diskutim Publik –Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2023-2027 si dhe me datën 07.12.2022, ka mbajtur konsultim publik në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 10:00.

Ecuria e Procesit

Komisioni punues në harmoni me ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna dhe në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike me datë 14.11.2022 ka publikur në web faqen e komunës Njoftimin për konsultim publik Projekt- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2023 – 2027.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/.../20/2022/11/Debat-publik-PLVMM.pdf>


<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php...>

Po ashtu ky dokument është publikuar edhe ne platformen e qeverise për konsultime publike.

linku: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php...>

Njoftimi për diskutim publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, po ashtu palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin, kohën për mbajtjen e takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Plani Lokal i Veprimit ne Mjedis 2023-2027 si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Ndërsa takimi konsultativ është realizuar në kohën e paraparë e të lartëcekur.



Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	30 ditë pranohen	15
2. Publikimi në ueb faqe	30 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **15** pjesëmarrës, prej tyre 7 femra dhe 8 meshkuj.

Takimin konsultativ për Plani Lokal i Veprimit ne Mjedis 2023-2027 e ka zhvilluar Hanushe Berisha anetare e Grupit punues nga DPUMM, ku ka njoftuar të pranishmit për qëllimin e debatit si dhe dispozitat e përgjithshme të Planit.

Anëtarja nga Grupi Punues Hanushe Berisha fillimisht para të pranishmëve ka prezentuar dokumentin që ka për qëllim :

Zgjidhjen e problemeve mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioritetëve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë akterët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve sipas një Plani të Veprimit.

Zhvillimin e shoqërisë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, që përfaqësojnë interesa të ndryshme përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin dhe komunitetin.

Rritjen e aftësisë së qeverisjes lokale dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioritetëve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plani të Veprimit.

Rritjen e shkëmbimit të informacioneve në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.

Ofrimin e zgjidhjes konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
Plani Lokal i Veprimit ne Mjedis 2023-2027.	Ne kuader te projekteve duke iu referuar ndotjes se ajrit dhe zhurmes tu kushtohet kujdes I veqant zones urbane / NBB dhe hapesirat per aktivitete afariste	Hyra Bytyci Zyra per informim/ Grupi I grave Lipjan	Kjo pjese eshte parapare me projekte konkrete dhe analiza ne kuader te \planit per cilesine e ajrit I parapar per vitin 2023	Komisioni pranon si koment I trajtuar .
Plani Lokal i Veprimit ne Mjedis 2023-2027.	Në kuadër të këtij Plani te integrohen te dhenat nga menaxhimi i mbeturinave	Xhelal Krasniqi – kompania “Pastrimi”	Komisioni ka sqaruar propozuesin e komentit se Menaxhimi I mbeturinave eshte pjese qe eshte ne trajtim ne kuader te Planit lokal per menaxhimin e mbeturinave I cili ehste aktualisht ne nivel te Draftit.	Koment : Pranuar dhe trjtim dhe inf. Per Komisionin I cili ehste ne pergaditje te PLMM .
Plani Lokal i Veprimit ne Mjedis 2023-2027.	Ndotja e ajrit nga aktivitetet minerare / niveli i ndotjes	Avni Sahiti Inspektor mjedisor	Në Komune nuk ka instrumente per matjen e nivelit te ndotjes se ajrit, dhe ne kuader te Planit ehste parapare hartimi I Planit dhe paisja me	Koment I pranuar dhe sqaruar /trajtuar ne kuader të Planit.

			instrumente matese te nivelit te ndotjes .	
	Komentet pranuar me shkrim			
Plani Lokal i Veprimit ne Mjedis 2023-2027.	Nuk eshte prezentuar ndonje koment	-		

Shtojë: Lista e pjesëmarrësve



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

DREJTORATI PER PLANIFIKIM, URBANIZEM DHE MBROJTJE TE MJEDISIT

DEBAT PUBLIK
PLANI LOKAL I VEPRIMIT NE MJEDIS 2023-2027

07.12.2022

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Pozita	Email adresa: Nr.tel.
1	HANUSHE BERISHA	DPUM M -	-	[Signature]
2	YALDIZE ULLASHA	DPUM M		[Signature]
3	Arifi RASHIDI	DI	Kryetar	X. Suleti
4	KAZEM KRASTHA	KRM, PASTRIK		M. K.
5	Hasim Vislerella	DPUM M		[Signature]
6	Milozin Miftari	DPZAR		[Signature]
7	Bekir Gjuller	LIP		[Signature]
8	Kusum Salihu	DPUM M		[Signature]
9	HARA MITYCI			H. M.
10	LABINOT DEDUHI	Dm.	Menaxher	[Signature]
11	Pendosa Jashanica	KK Lipjan	Z. Informim	[Signature]
12	AVNI JASHARI	KK LIPJAN	SHAKADINEN	[Signature]
13	DANT AZEMI	KK LIPJAN	KRYESUES	[Signature]
14	Leonora Aslani		Adm. Publike	[Signature]
15	Ferdion Shala	Qytetar		[Signature]
16				
17				
18				
19				
20				